



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.476/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së fushatës në institucione publike në Fushë Kosovë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 11.02.2025, mori këtë:

### **V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.476/2025 e datës 09.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Me datë 09.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën theksohet Më 07.02.2025 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje! Qendra në Skenderaj kanë vërejtur se zyrtari i Partisë Demokratike të Kosovës, z.Sami Lushtaku më datë 07.02.2025 për qëllime politike, elektorale ka mbajtur takim me mësimdhënësit e Komunës së Skenderajt, takim të cilin po ashtu e ka postuar në rrjetin social Facebook. Me veprimet e tij zyrtari i lartcekur ka shkelur dispozitat e nenit 36 paragrafi 2 i LZP-së në të cilën shprehimisht është e përcaktuar se: " Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon Ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij Ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik". Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur foto nga rrjeti social facebook.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK ka theksuar veprimet e ankimuara nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, kufizohen vetëm nëse të njëjtat kryhen

gjatë orarit të rregullt të punës, e që në ne rrethanat e rastit konkret mësimdhënësit e përfshirë në këtë tubim me z. Sami Lushtaku, nuk janë takuar në orarin e rregullt të punës dhe për më tepër nuk janë as në ambiente të ndonjë shkolle publike, mirëpo në hapësira të kontraktuara nga Partia Demokratike e Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli duke vlerësuar provat e bashkangjitura ankesës dhe bazuar në përgjigjen e bashkangjitur nga Subjekti Politik PDK, ka gjetur se bazuar ne dispozitat ligjore te LZP-se veprimet e ankimuar do të kufizoheshin nëse të njëjtat kryhen gjatë orarit të rregullt të punës dhe në ambiente të ndonjë shkolle publike. Andaj sipas bindjes se Panelit subjekti politik PDK ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura, pasi që nuk është provuar se tubimi i mbajtur ka qenë në ndonjë shkollë dhe nuk është vërtetuar me asnjë prove se ka qenë në orar të rregullt të punës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoi se pretendimet e palës ankuese se mbajtja e tubimit nga z.Sami Lushtaku është bërë me mësimdhënës të komunës së Skenderajit gjatë orarit të punës dhe në shkollë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtresuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.476/2025 më datën 11.02.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.